



This programme is funded
by the European Union



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Korçë

VITI 2018

Tabela e Përmbajtjes

GJETJET KRYESORE	3
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË KORÇË	4
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2018	5
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	5
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.....	11
REKOMANDIME.....	12

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2018.

Gjetjet Kryesore

- Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, në Bashkinë Korçë për vitin 2018 janë evidentuar 187 raste të dhunës në familje, ku për 125 të tyre u kërkua Urdhër Mbrotje.
- Gjatë vitit 2018 në Gjykatën e rrethit Korçë janë paraqitur në padi civile 190 raste të reja për Urdhër Mbrotje.
- Mekanizmi i Referimit bashkia Korçë për vitin 2018 ka trajtuar 16 raste.
- Përgjatë vitit 2018 janë organizuar edhe takime informuese me nënat e fëmijëve të Qendrës Multifunkionale mbi aspektet e barazisë gjinore, martesat e hershme dhe funksionimin e mekanizmit të referimit të rasteve kundër dhunës në familje në bashkëpunim me Misionin Emanuel.
- Bashkia Korçë edhe për vitin 2018 ka zbatuar dy projekte të financuara nga buxheti i saj, për të asistuar rastet e dhunës në familje dhe për sensibilizimin qytetar ndaj fenomenit.
- Strehëza emergjente ka dhënë shërbim gjatë gjithë vitit 2018 për 6 (gjashtë) përfitues gjithsej: 4 (katër) gra, 2 (dy) fëmijë të shoqëruar nga nënat e tyre.
- Në total pesë aktivitete të koordinuara janë realizuar gjatë këtij viti nga organizatat e shoqërisë civile dhe Bashkisë.
- Përgjatë vitit 2018 punonjësit e bashkisë Korçë kanë marrë disa trajnime në kuadër të dhunës në familje.
- Bashkia Korçë nuk ka kryer aktivitete të përbashkëta me organizatat fetare, por ka përfshirë në aktivitete ato organizata fetare që janë pjesë e MKR-së, si “Jezus Krishti për Ballkanin” apo Fondacioni “Kenedi”.
- Përgjatë vitit 2018 janë organizuar 4 mbledhje të zakonshme të Grupit Teknik Ndërdisciplinar dhe një mbledhje e Komitetit Drejtues të bashkisë.
- Tetë janë në total numri i grave kryefamiljare, viktime të dhunës në familje që kanë marrë bonus strehimi përgjatë vitit 2018.
- Gjatë vitit 2018 nuk ka pasur raste që kanë shkuar në strehëz në Kamëz.
- Përgjatë vitit 2018 janë plotësuar 5 Kërkesë Padi nga Bashkia Korçë. Përgjithësisht këto kërkesë padi, plotësohen nga inspektorët e lagjeve në komisarjat.
- Shërbimi i provës megjithë publikimin e statistikave në rang kombëtar dhe rajonal, nuk i ndan ato sipas llojit të veprës penale, gjinisë si edhe llojit të dënimit alternativ të kryer.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Korçë

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Bashkinë Korçë për vitin 2018 janë evidentuar 187 raste të dhunës në familje, për 125 të tyre u kërkua Urdhër Mbrojtje.

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë e Policisë Vendore të Bashkisë Korçë

Dhuna në familje	Bashkia Korçë	Burra	Gra
Raste te evidentuara	187		
Vrasje raste			
Viktima			
Kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje	125		
Shkelje Urdhër Mbrojtje	14		
Vepër penale- Neni 130/a	35		
Autorë të arrestuar	18		
Autorë të ndaluar	1		
Autorë të shpallur në kërkim			
Autorë në gjendje të lire			
Autorë të vetvuarë			

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit

Gjatë vitit 2018 në Gjykatën e rrethit Korçë janë paraqitur në padi civile, 2 raste të reja për padi zgjidhje martesë. Gjithashtu gjatë këtij viti janë trajtuar gjithsej 268 raste për Urdhër të menjëhershëm Mbrojtje, nga të cilat 190 raste të reja që i përkasin vitit 2018 dhe 79 raste të mbartura nga një vit më parë.

Ndërkohë po nga kjo gjykatë për vepra penale janë trajtuar si kundravajtje 27 vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes (Neni 124 – 133 K.P) dhe 4 raste të reja për dhunë në familje.

Mekanizmi i Referimit bashkia Korçë për vitin 2018 ka trajtuar 14 raste.

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2018

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Korçë ka realizuar fushata sensibilizuese në qytet dhe në zonat rurale, me nxënësit e shkollave. Në kuadër të këtyre fushatave janë vendosur dhe shpërndarë fletëpalosje në të gjitha rajonet administrative me qëllim që informacioni të shkojë në të gjithë territorin e Bashkisë. Gjithashtu janë organizuar takime informuese me anëtarë të komunitetit për çështjet gjinore dhe të drejtën pronësore kjo në bashkëpunim me shoqatën Nisma ligjore qytetare.

Përgjatë vitit 2018 janë organizuar edhe takime informuese me nënat e fëmijëve të Qendrës Multifunkionale mbi aspektet e barazisë gjinore, martesat e hershme dhe funksionimin e mekanizmit të referimit të rasteve kundër dhunës në familje në bashkëpunim me Misionin Emanuel.

Koordinatori vendor ka marrë pjesë në dy emisione radiofonike dhe në tre emisione televizive mbi arritjet dhe sfidat që has MKR dhe Bashkia Korçë si koordinuese e mekanizmit. *(Një emision televizive është bërë në kuadër të bashkëpunimit me shoqatën Refleksione, në kuadër të një projekti me qëllim monitorimin e MKR Korçë)*

Gjatë takimeve informuese janë përdorur fletëpalosje si materiale promocionale, këto të mundësuar nga Bashkia Korçë.

Bashkia Korçë në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm të këtij qarku kanë organizuar pesë aktivitete sensibilizuese për vitin 2018. Ky bashkëpunim është koordinuar me:

- Dorkas/Emanuel;
- Gruaja në Zhvillim Korçë;
- Shoqata Qëndistaret;
- Drejtorja e Policisë;
- Drejtorja e Arsimit (shërbimi psiko-social);
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Zyra e Punës dhe Shëndeti Publik.

Bashkia Korçë edhe për vitin 2018 ka zbatuar dy projekte të financuara nga buxheti i saj, për të asistuar rastet e dhunës në familje dhe për sensibilizimin qytetar ndaj fenomenit: *“Strehëza emergjente për viktimat e dhunës në familje”* dhe *“Ndërgjegjësimi i komunitetit rural nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje”*. Buxheti i vënë në dispozicion për këto dy projekte ishte 424.900 lekë gjithsej.

Nëse bëhet një krahasim me vitin 2017 figuron një buxhet më i ulët, por në sipas informacioneve nga bashkia, është ulur shuma e qerasë mujore së banesës që shërben si strehëz në bazë të marrëveshjes.

Strehëza emergjente ka dhënë shërbim gjatë gjithë vitit 2018. Në këtë periudhë dymbëdhjetë mujore janë strehuar 6 (gjashtë) përfitues gjithsej: 4(katër) gra, 2 (dy) fëmijë të shoqëruar nga nënat e tyre.

Bashkia Korçë ka bashkëpunim shumë të mirë me bashkitë rajonale, duke dhënë ndihmesën e saj në rang qarku, për ato bashki kufitare, të cilat nuk kanë ende shërbime të plota për viktimat e dhunës në familje. Gjatë 2018 pranë kësaj bashkie është referuar një rast nga bashkia Devoll për asistim me strehimin emergjent për viktimën e dhunës në familje deri në akoordinimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes. Zonja A.Sh është sistemuar në strehëz për një afat 72 orësh, duke marrë shërbim të plotë prej bashkisë Korçë, si shërbim psiko-social, ushqim dhe veshbathje.

Në lidhje me aktivitetet sensibilizuese, janë përfshirë rreth 300 nxënës në ambjentet e shkollave, ndërsa me dhjetra të tjerë janë informuar nëpërmjet matërialeve promocionale, të cilat janë shpërndarë në shkollë nga mësuesit kujdestarë.

Rreth 100 qytetarë kanë marrë pjesë në aktivitete informuese më tema të caktuara në ambiente të mbyllura dhe me dhjetra qytetarë janë informuar nëpërmjet emisioneve televizive dhe radiofonike në televizionet lokale. Gjithashtu dhjetra qytetarë kanë marrë informacion gjatë aktiviteteve sensibilizuese në zona të caktuara të qytetit.

Fokus ishin target grupet e nxënësve të shkollave të mesme; të rinj e të reja të qendrës Rinore Korçë; qytetarë; gra dhe burra anëtarë të komuniteteve në nevojë dhe pakicave kombëtare.

Në total pesë aktivitete të koordinuara janë realizuar gjatë këtij viti nga organizatat e shoqërisë civile dhe Bashkisë:

- Dy aktivitete me temë mbi barazinë gjinore janë realizuar nga Misioni Emanuel e Dorkas me prindërit e qendrës multifunkcionale.
- Dy aktivitete sensibilizuese mbi dhunën në familje janë organizuar nga Shoqata Gruaja në zhvillim Korçë me temë “Stop dhunës në familje” në bashkëpunim edhe me DAR, ku kanë marrë pjesë dhe nxënësit e shkollës “Themistokli Gërmenji”.
- Një mbledhje e vecantë e Bordit Këshillimor qytetar është organizuar për problematikat lidhur me barazinë gjinore dhe rolin e gruas në vendimmarrje.

OSHC-të që operojnë dhe bashkëpunojnë me Bashkinë Korçë:

1. Gruaja në Zhvillim Korçë.
2. Misioni Emanuel dhe Dorkas.
3. Agjencia Rajonale e Zhvillimit nëpërmjet Bordit Këshillimor Qytetar.

Gjatë vitit 2018 është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me shoqatën Refleksione mbi monitorimin e MKR-së Korçë.

Përgjatë vitit 2018 punonjësit e bashkisë Korçë kanë marrë disa trajnime në kuadër të dhunës në familje, specifikisht në:

1. *“Vajzat-më shumë politika gjinore në Bashkinë Korçë”* organizuar nga Organizata Trajnim Edukim dhe Demokraci (TED) në bashkëpunim me Organizatën “Community Develop Center”(CDC).
2. *„Fuqizimi i shërbimeve të ofruara për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje Korçë“* nga UNFPA
3. *„Shërbimet dhe trajtimin e viktimave të dhunës seksuale“* trajnim i marrë në Korenë e Jugut mundësuar nga UNDP
4. *„Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi për të Miturit“* organizuar nga Fondacioni "Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarreveshjeve"
5. *„Trajnim mbi të drejtat e personave LGBTI“*, organizuar nga BE dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
6. *„Trajnim mbi asistimin e komunitetit LGBT ne Strehëz“* bashkëpunim me nëpunësit gjinorë për referimin e rasteve të dhunës ndaj këtij komuniteti.

Gjatë vitit 2018 nuk ka patur trajnime të përbashkëta të të gjithë mekanizmit të Bashkisë Korçë.

Ndërkohë që në kuadër të zbatimit të Planit Gjiner Bashkia Korçë ka bashkëpunim të vazhdueshëm me UN Women.

Tabela 2. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizua nga:
1	16 shkurt	Shk “Ismail Qmali”	“Barazia Gjinore dhe prindërimi”	Ëord Vison dhe Bashki
2	2 Mars	“Kopshti rrom”	“Martesat e hershme/ barazia gjinore dhe prindërimi” me nënat e fëmijëve	Bashkia Korçë
3	8 Prill	“Kopshti rrom”	“ Vlerat e gruas në shoqëri” me nënat	Bashkia Korçë
4	16 Maj	Shk“Ymer Dishnica”	“Dhuna në familje dhe legjislacioni”	Bashkia Korçë/DAR shërbimi psiko-social
5	22 Maj	Nj.A Voskop	“ Dhuna në familej Legjislacioni”	Bashkia Korce/Nja

6	26 Nëntor	Shk. “Themistokli Gërmenj” qytet	Celja e fushatës kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave	Bashkia/Gruaja në Zhvillim Korce/Instituc Rajonale
---	-----------	----------------------------------	---	--

Bashkia Korçë nuk ka kryer aktivitete të përbashkëta me organizatat fetare, por ka përfshirë në aktivitete ato organizata fetare që janë pjesë e MKR-së, si “Jezus Krishti për Ballkanin” apo Fondacioni “Kenedi”.

Këto Fondacione në shërbesat e tyre fetare predikojnë për familjen e shëndetshme sipas mësimëve fetare dhe për pasojat negative që sjell dhuna në familje.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Edhe për vitin 2018, ashtu siç edhe në 2017-ën, funksionimi i mekanizmit të referimit rezulton të jetë disi i mirë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore nga ana e bashkisë së Korçës. Në bazë të të dhënave të mbledhura nga bashkia dhe rezultatet e monitorimit të punës së bashkisë, rezulton se bashkia Korçë ka kapacitetet e duhura për të përdorur mekanizmin e referimit dhe ofrimin e eksperiencave të saj.

Përgjatë vitit 2018 janë organizuar 4 mbledhje të zakonshme të Grupit Teknik Ndërdisciplinar, konkretisht në datë 9 janar, 30 mars, 5 korrik dhe 1 nëntor 2018. Në këto mbledhje kanë marrë pjesë përfaqësues nga: Bashkia Korçë, Drejtoria Shëndetit Publik, Policia, Drejtoria Arsimore, Gjykata, Zyra e Punës, Shërbimi Social Shtetëror dhe dy fondacione, “Fondacioni Kenedi” dhe Fondacioni “Jezus Krishti për Ballkanin”. Nga ana tjetër Prokuroria dhe Shërbimi Përmbarimor, rrallë herë marrin pjesë në këto takime.

Mbledhja e radhës e Komitetit Drejtues të bashkisë u organizua në 3 Dhjetor 2018 me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve rajonale.

Në mbledhjet e MKR-së Korçë për vitin 2018 janë trajtuar 16 raste.

Ndërkohë që koordinatoresha vendore shpërndan me anëtarët e MKR-së raportet e mbledhjeve periodike si dhe ato të rasteve emergjente. Ndërsa në lidhje me shkëmbimin e informacionit me Drejtorinë e Policisë ky raportim bëhet çdo muaj.

Sistemi i hedhjes të të dhënave “Revalb” në lidhje me statistikat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie përditësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk ka probleme në përdorimin apo plotësimin e tij. Koordinatorja i hedh këto të dhëna sapo merr raportimin nga institucionet përkatëse.

Tetë janë në total numri i grave kryefamiljare, viktimat të dhunës në familje që kanë marrë bonus strehimi përgjatë vitit 2018.

Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucione dhe OJF të ndryshme në bazë të memorandumeve të bashkëpunimit për referimin e rasteve sipas specifikës së tyre. Raportet e përcjella nga Shërbimi i Provës në MD faqja elektronike e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës

Koordinatorë vendore kundër dhunës me bazë gjinore për Bashkinë Korçë është znj. Elizaveta Bita që prej vitit 2010, vit që bashkia e Korçës ka krijuar pozicionin e koordinatorit vendor përgjegjës për luftën kundër dhunës në familje. Ky pozicion ekziston brenda strukturës organizative të bashkisë së Korçës dhe përfshihet në statusin e nëpunësit civil, duke pasur kështu edhe detajim të detyrave dhe përgjegjësi. Sipas të dhënave të përfuara nga bashkia ky pozicion nuk ka role të tjera në bashki, duke lejuar kështu përqendrim të plotë tek lufta kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Detyrat e këtij pozicioni janë performuar në 8 vitet e fundit nga i njëjti person. Koordinatori vendor ka marrë pjesë në disa trajnime mbi dhunën në familje dhe çështjet gjinore, duke përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës seksuale. Më specifikisht është zhvilluar një trajnim në datat 23-24 tetor 2017 "Forcimi i ekipit multidisiplinar kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje" zhvilluar nga PNUD dhe UNFPA. Më tej në datat 22-29 Prill është zhvilluar "Trajnim mbi shërbimet për viktimat e dhunës seksuale.(PNUD) 7 qershor 2018, Qendra Altri" T drejtat e viktimave të veprë penale" ku përmendeshin përveç viktimave të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje. Koordinatori vendor nuk është në dijeni të ekzistencës së një moduli të unifikuar të Shkollë Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) rreth trajnimeve të zhvilluara.

Megjithëse bashkëpunimi për rastet e dhunës në familje i Bashkisë Korçë me policinë paraqitet si shumë i mirë për vitin 2018, nuk ka dokumenta që e vërtetojnë këtë bashkëpunim, duke qenë se ky është i përditshëm dhe kryhet në bazë të marrëveshjes mes dy institucioneve.

Gjithashtu, edhe në rastin e bashkëpunimit me Zyrën e Punës, nuk ka dokumenta mbështetëse që vërtetojnë bashkëpunimin mes dy institucioneve. Ndiqet procedura nga bashkia, institucion ky që referon rastet e punësimit dhe më pas zyra e punës e ndjek këtë procedurë për mundësinë e punësimit të referuar nga bashkia.

Me drejtorinë Arsimore bashkëpunohet në rast të aktiviteteve sensibilizuese me shkollat, ndërkohë që me shërbimin psiko-social bashkëpunon NJMF në rast se i referohet ndonjë problematikë nga ky shërbim ose nga stafi pedagogjik.

Duke qenë se edhe Shërbimi Social është pjesë e MKR, sa herë ka pasur nevojë për sistemim të viktimave të dhunës në Strehëzën Kombëtare, ky institucion është përfshirë. Gjatë vitit 2018 nuk ka pasur raste që kanë shkuar në strehëz në Kamëz.

Urdhërat e mbrojtjes (UM) dhe ata të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM) plotësohen nga komisariati, Bashkia Korçë si dhe nga avokatë, të punësuar privatisht nga viktimat.

Përgjatë vitit 2018 janë plotësuar 5 Kërkesë Padi nga Bashkia Korçë. Përgjithësisht këto kërkesë padi, plotësohen nga inspektorët e lagjeve në komisarariat.

Tabela 3. Numri i mbledhjeve të GTN-së në vitin 2018 në Bashkinë Korçë

Viti	Mbledhjet e GTN
2018	Mbledhja e pare – Date 09/01/2018 – U trajtua rasti i F.B
2018	Mbledhja e dyte – Date 30-03.2018 – Prezantimi i gjetjeve lidhur me situatën sa i takon nevojës për shërbime për viktimat e dhunës seksuale.
2018	Mbledhja e tretë- Datë 05/07/2018- Njohja e MKR me ndryshimet ligjore te ligjit” Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”-Statistikat. –Rasti K.Gj, referuaj nga Nj.A Mollaj. Rasti P.D referuar nga Nj.A Drenovë. Rasti S. M referuar nga Nj.A Drenovë.
	Mbledhja e katërt-Datë 01/11/2018-U kërkua bashkëpunimi i SPZ me koordinatorin vendor për vizitat në familje për qytetarët e pajisur me UM. Janë trajtuar rastet e referuara nga Nj.A Sh. Q, M.M, Q.Z. Anëtarët e MKR do të amrrin pjesë dhe gjatë aktiviteteve të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas.

Burimi: Bashkia Korçë

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Korçë

Viti	Mbledhjet e KD
2018	Mbledhja datë 03/12/2018- Kanë marrë pjesë të gjitha institucionet rajonale

Burimi: Burimi Bashkia Korçë

TABELA E Keshllit drejtes

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2017
Bashkia Korçë	Sotiraq Filo
Drejtoria e Policisë	Lorenc Panganika
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Admir Belishta
Prokuroria e Rrethit	Dhorina Theodhori
Drejtoria Arsimore Rajonale	Kristaq Grabocka
Drejtoria e Shëndetit Publik	Mikel Llogori
Zyra e Përmbartimit	Olta Shkëmbi
Drejtoria e Shërbimit Social shtetëror	Mariana Lorgji
Fondacioni Jezus krishti për Ballkanin	Lorenc Ahmet
Fondacioni Kenedi	Ian Loring
Zyra e Punës	Florenc Tabaku

Tabela 5. GTN-ja e Bashkisë Korçë viti 2018 (KONTROLLONI EMRAT SE MUND TE JETE NRDYSHUAR NDONJE)

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2017
Bashkia	Illir Zguri Drejtor i Kujdesit Social Elizeta Bita Specialiste KDHFdhe BGj
Drejtoria e Policisë	Dhurata Ahmeti specialiste
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Esmerald Xhafa kancelar
Prokuroria e Rrethit	Ollga Visi
Drejtoria Arsimore Rajonale	Jorgjeta Babliku, Dorian Balli
Drejtoria e Shëndetit Publik	Elisabeta Dino
Zyra e Përmbartimit	Olta Shkempi (Kryetare)
Administratoret shoqërorë të Njësisë Administrative	
Zyra e Punësimit	Helena Zhappa
Fondacioni Jezus Krishti për ballkanin	Daniela Ahmet
Fondacioni e Kenedi	Erjon Jonuzllari
Komunitete fetare	Nuk ka
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk ka

Burimi: Bashkia Korçë

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Gjatë vitit 2018 në Gjykatën e rrethit Korçë janë trajtuar gjithsej 190 raste për Urdhër të menjëhershëm Mbrojtje.

Gjykata nxjerr vendime bazuar në ligj dhe kërkesë padi, duke mos pasur alternativa për shërbime të tjera të dhëna nga shteti apo nga OSHC.

Edhe për vitin 2018, situata vijon të jetë e njëjtë, duke qenë se në Korçë nuk ka qendra rehabilituese, as qendra ku të jepet shërbim psikologjik apo terapi grupi, apo për rehabilitim e personave që janë përdorues të lëndëve narkotike dhe alkoolit. Dhunuesit që janë përdorues të lëndëve narkotike janë shumë problematikë dhe pjesa më e madhe e tyre janë të rinj, të cilët përveç shkaktimit të problemeve ekonomike janë ushtrues të dhunës psikologjike dhe fizike tek prindërit dhe të afërmit e tyre.

Njësoj si në vitin 2017, edhe për 2018-ën, shërbimi i provës megjithë publikimin e statistikave në rang kombëtar dhe rajonal, nuk i ndan ato sipas llojit të veprës penale, gjinisë si edhe llojit të dënimit alternativ të kryer. Kjo e pengon krijimin e një panorame të saktë për dënimet alternative dhe përpjekjet rehabilituese të autorëve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Aktualisht shërbimi i provës në bashkinë e Korçës vijon të ketë mangësi.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Korçës për vitin 2018, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Korçë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Rekomandojmë që GTN-ja e kësaj bashkie duhet të mblidhet në mënyrë të rregullt çdo muaj, duke qenë se në vitin 2018, ky grup është mbledhur vetëm 5 herë.
- Në territorin e Bashkisë Korçë nuk ka asnjë organizatë apo qendër që të mundësojë programe këshillimi për djemtë dhe burrat ose të mundësojë trajtimin dhe rehabilitimin e dhunuesve. Ka pasur raste të menaxhuara që nuk janë raste suksesi, sepse në Korçë nuk ka qendra rehabilituese për personat me varësi nga drogë dhe alkoolit, ndaj ngritje e një qendre të tillë është një nga rekomandimet tona më të forta për këtë bashki.
- Rekomandojmë trajnime të përbashkëta ku të marrin pjesë të gjithë anëtarët e mekanizmit në mënyrë që zbatueshmëria e ligjit të jetë sa më efektive dhe informacioni të jetë i plotë edhe për ata anëtarë që janë zëvendësuar ndër vite brenda mekanizmit të referimit. Ndryshimi i herë pas hershëm i përfaqësuesve të institucioneve publike pjesë e MKR, për bashkinë Korçë ka sjellë problematika në menaxhimin e rasteve ashtu siç duhet.
- Dhënia e shërbimit emergjent për viktimat e dhunës në familje pa organizat partnerë do të ishte shumë i vështirë për menaxhim në territorin e kësaj bashkie. Nuk ka staf dhe buxhet për mbulimin e shërbimit psiko-social dhe ndihmës së drejtpërdrejtë për përfituesit. Ndaj rekomandohet adresimi dhe alokimi i fondeve nga bashkia Korçë për këtë problematikë.
- Shërbimi brenda në strehëz rekomandohet që të përmirësohet.
- Të mbijetuarat e dhunës orientohen gjithmonë drejt punësimit me anë të ndërmjetësimit të Zyrës Rajonale të Punësimit, por në shumicën e rasteve ato nuk shkojnë për të punuar, ndaj është e nevojshme një ndërhyrje edhe më e thellë dhe e detajuar për integrimin e tyre.
- Në Korçë nuk ka mundësi për trajtim rehabilitues afatgjatë për viktimat e dhunës në familje. Ky është një tjetër rekomandim përsa i përket menaxhimit në vazhdimësi pas kalimit të fazës së emergjencës.